



KUVENDI I MALIT TË ZI
Sektori për marrëdhënie me publikun

Podgoricë, 2. dhjetor 2019

MEDIEVE- Deklaratë

Nënkryetari Genci Nimanbegu dhe delegacioni i Kuvendit të Malit të Zi qëndruan në Republikën e Shqipërisë

Delegacioni i Kuvendit të Malit të Zi, i udhëhequr nga nënkryetari i Kuvendit dhe Kryetari i Gruponit të miqësisë së Kuvendit të Malit të Zi me Parlamentin e Republikës së Shqipërisë **Genci Nimanbegu** ka vizituar dje zonat e prekura nga goditura nga tërmeti në Republikën e Shqipërisë, Lezhën, Shëngjinin, Bubqin dhe Durrësin.

Me këtë rast, nënkryetari i Kuvendit Genci Nimanbegu, në emër të tërë delegacionit, e përcjelli mesazhin e solidaritetit kombit shqiptar dhe udhëheqjes shqiptare, me dëshirë që pasojat e tërmetit t'i tejkalojnë sa më shpejt. Ai i lajmëroi bashkëbiseduesit se delegacioni parlamentar do ta njoftoi Kuvendin e Malit të Zi mbi informatat e fituara në terren, me qëllim të gjetjes së mënyrës që shteti ynë ta ofrojë ndihmën e duhur shtetit fqinj mik. Nënkryetari gjithashtu e përcolli gatishmërinë e popullit të Malit të Zi, në veçanti popullatës së zonës së Ulqinit, që edhe vetë në vitin 1979 ishin viktimat e tërmetit, që të ndihmojnë në akomodimin eventual të njerëzve, që mbeten pa kulm mbi kokë.

Delegacionin e Kuvendit e priti dhe gjatë gjithë vizitës e shoqëroi **nënkryetarja e Parlamentit të Republikës së Shqipërisë, Vasilika Hysi**. Gjatë vizitës, delegacioni u takua me **nënkryetarin e Qeverisë së Shqipërisë dhe deputetin, Erjon Braçe, ministrin e punëve të brendshme Sandër Lleshaj, prefektin e prefekturës së Durrësit Roland Nasto, prefektin e prefekturës së Lezhës Pjertin Ndreu, drejtoreshën e njësisë shëndetësore Lezhë, Zoja Zefaj**, si dhe me **vullnetarët e organizatës joqeveritare “Amaneti” nga Ulqini**.

Në fund të vizitës, delegacioni u takua edhe me **kryeministrin e Shqipërisë Edi Ramën** dhe ministrin e turizmit dhe mjedisit jetësor të Shqipërisë **Blendi Klosin**, që shprehen falënderim të posaçëm Malit të Zi për solidaritetin dhe ndihmën, si dhe delegacionit të Kuvendit për vizitën.

Në Durrës delegacioni u takua edhe me përfaqësuesin e asamblesë shtetërore të Nju Jorkut, me prejardhje nga Ulqini, **Mark Gjonaj**, që udhëheq ekipin e inxhinierëve ekspertë nga SHBA-të.

Delegacioni vizitoi qendrat e strehimit në Lezhë dhe Durrës, Qendrën operacionale të prefekturës së Lezhës, rrënojat e objekteve banesore dhe të tjera, biseduan me anëtarë të familjeve

që kanë humbur familjarë dhe në vendin e ngjarjes u bindën mbi shkatërrueshmërinë e tërmetit, që e goditi Shqipërinë fqinje, më 26. nëntor 2019.

Nikoqirët e takimit e njoftuan delegacionin e Kuvendit me pasojat e tërmetit, me mënyrën e tejkalimit të shokut fillestar, vendosjen e qytetarëve të goditur nga tërmeti në hotelet e kategorive të larta, ndërsa në pjesët rurale në çadra, si dhe me nevojat e tyre, duke cekur se përpos nevojave në të holla, në medikamente, veshmbathje, ushqim të konservuar, batanije dhe shtretër, rëndësi të madhe për ta do të ishte sikur inxhinierët e ndërtimtarisë nga Mali i Zi të ndihmonin në vlerësimin e shkallës së dëmtimit të objekteve dhe përcaktimin e kushteve eventuale të tyre për banim.

Gjithashtu, nikoqirët shprehen falënderim të jashtëzakonshëm për Qeverinë e Malit të Zi, dy ministrat e të cilës ishin ndër të parët në vendin e ngjarjes, si dhe ekipit të shpëtimtarëve nga Mali i Zi, që u angazhuan që nga dita e parë e deri në përfundimin e aksionit të kërkim-shpëtimit.

Me koordinimin e aktiviteteve të nënkryetarit të Kuvendit dhe OJQ-së „Amaneti“, ndihma e mbledhur nga qytetarët e komunës së Ulqinit iu dorëzua banorëve të komunës së Bubqit.

Përpos nënkryetarit Nimanbegu, në delegacion të Kuvendit të Malit të Zi ishin edhe deputetët: Luigj Shkreli, Halil Dukoviq, Ana Nikoliq, Mirsad Muriq, Nexhad Dresheviq dhe Danijella Paviqeviq.

Më takime mori pjesë edhe e ngarkuara me punë në Ambasadën e Malit të Zi, **Vesna Radonjiq** dhe sekretari i parë i ambasadës në Tiranë, **Danillo Brajoviq**.

SEKTORI PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN